




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 5 pika 2 të Ligjit për Zonë Ekonomike me Nr.04/L-159, neni 17, pika 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-174, për Planifikim Hapësinorë, neni 8 pika 3 dhe neni 9 pika 1 të Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Nr.2010/03-L-230, dhe neni 36 pika 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seancën e mbajtur më 31.10.2016, aprovon këtë:

V E N D I M

Për shpalljen në shqyrtim publik për planin rregullues të hollësishëm (PRRH) dhe vlerësimin strategjik mjedisor (VSM) për zonën "Park industrial" në fshatin Budrikë e Epërme

Neni I

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë, MIRATON vendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik, Planin Rregullues të Hollësishëm dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor për zonën park industrial në fshatin Budrikë e Epërme.

Neni II

Plani rregullues nga neni 1 i këtij vendimi, përbehet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni III

Plani rregullues nga neni 1 i këtij vendimi, i lihet në dispozicion për diskutim publik të gjithë qytetarëve të interesuar, organeve dhe institucioneve të Komunës së Vitisë, në afat prej 30 ditëve. Hapja e shqyrtimi publik do të bëhet më 17.11.2016 (e Enjte), në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti, duke filluar nga ora 10:00.

Neni IV

Qëllimi i këtij shqyrtimi publik, është për të krijuar opinione pozitive për propozim PRRH dhe VSM, për Zonën ekonomike me Status "Park Industrial".

Neni V

Pas përfundimit të kohës për shqyrtim, komentim dhe finalizim të tij, propozim plani i dërgohet Kuvendit të Komunës për miratim final.

Neni VI

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi.

Neni VII

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit
2. Drejtorisë për Urbanizim, Planifikim
3. Drejtorisë për Kadastër, Pronë
4. MAPL
5. Shërbimit të Kuvendit
6. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

